



## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

**UNI – UNIVERSUM International College - Prishtinë**

dhe

**Termokos**

### 1. Qëllimi i Memorandumit

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që të krijohet partneritet institucional për të aplikuar për punë praktike për studentët tanë të **UNI – UNIVERSUM International College**, sipas nevojave dhe interesit tuaj.

### 2. Fushëveprimtaria

Ky memorandum ju dërgohet me qëllim të shprehjes së interesit tonë për studentët tanë që të kryejnë një punë praktike në Zyret tuaja në Termokos në të gjitha Departamentet e kërkuara sipas kërkesave dhe nevojave tuaja.

Studentët tanë pas përfundimit të një periudhe të mjaftueshme studimi dhe pas mbajtjes së disa lëndëve thelbësore, janë të gatshëm të aplikojnë për njohuritë dhe aftësitë e tyre në një ambient praktik.

Arsyeja për zgjedhjen e kompanisë suaj është përvoja e pasur dhe reputacioni i saj në fushat e caktuara. Ne besojmë se studentët tanë duke punuar në këtë kompani do të mund të përfitojnë shumë përvojë dhe do të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të pasur një karrierë të suksesshme në fushën e studimeve të përfunduara.

Për këtë arsye, ju lutemi që të pranoni praktikant në kompaninë tuaj Termokos, për një periudhë kohore prej 3 - 6 muaj, duke përfshirë të gjitha departamentet e institucionit. Studentët tanë janë të gatshëm të angazhohen në detyra të ndryshme dhe të marrin pjesë në projekte që do të përcaktohen nga ana juaj.

## **MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË**

në mes të

**Kolegjit UNI –Universum International College Powered by Arizona State University**

dhe

**Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Komuna e Prizrenit**

### **I. Qëllimi i Memorandumit**

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

### **II. Fushëveprimtaria**

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Qendra e mjekësisë familjare në Prizren do t'u mundësoj studentëve të Programeve Shëndetësore të Kolegjit UNI përfundimin e punës praktike në qendrën e mjekësisë familjare në Prizren, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji UNI do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga përgjegjësi i caktuar nga qendra e mjekësisë familjare në Prizren
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji UNI, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e QKMF.
4. Kolegji UNI do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.


### III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është pa afat kohor.
5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 25.04.2025

### PALËT NËNSHKRUESE


**Kolegji UNI – Universum**



Alejtin Berisha  
Drejtori Ekzekutiv



**QKMF - Komuna Prizren**



Dr. Fadil Bajraktari  
Drejtori QKMF-së

